



K.F. "GJAKOVA"

Republika e Kosovës  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
Komuna e Gjakovës - Opština Đakovica  
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative  
Uprava za Opšta Administrativne Poslove

DA Nr. 413/d-27229  
Data 01.10.2018  
Gjakovë - Đakovica - Gjakova

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me datë. 01.10.2018, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;
2. Klubit Futbollistit K.F. "Gjakova" të cilin e përfaqëson sekretari i klubit Sadik Byci, në tekstin vijues K.F. "Gjakova".

### Neni 1

#### Qëllimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim mbulimin e një pjese të shpenzimeve të pjesëmarrjes në gara të Klubit K.F. "Gjakova" në Kampionatin e Ligës së dytë të Kosovës grupi (A).

### Neni 2

#### Obligimet e Komunës

2.1. Komuna e Gjakovës do të sigurojë mjetet financiare në vlerë prej 2,500.00€ për përkrahjen e klubit futbollistik K.F. "Gjakova" për pjesëmarrje në gara në Kampionatin e Ligës së dytë të Kosovës grupi (A). Evropiane. Mjetet që do të ndahen për klubin futbollistik K.F. "Gjakova" duhet të jenë të argumentuara nga K.F. "Gjakova" në bazë të shpenzimeve të parapara.

2.2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që sipas faturave që pasqyrojnë shpenzimet e bëra nga K.F. "Gjakova" dhe pas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë financiare të Zyrës së Kryetarit të Komunës të fillojë procedurat e ekzekutimit të pagesës. Shpenzimet do të realizohen nga kategoria mallra dhe shërbime të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

### Neni 3

#### Obligimet e K.F. "Gjakova"

K.F. "Gjakova" obligohet që t' i sjellë të gjitha faturat për shpenzimet e bëra lidhur me aktivitetet e saj në Gjakovë ku përmes të cilave do të pasqyrohen shpenzimet e bëra.

Të gjitha faturat duhet të dorëzohen në organet e administratës komunale së bashku me llogarinë bankare.

#### Neni 4

Ky memorandum i bashkëpunimit është përpiluar në 3 ekzemplarë të njëjtë, prej të cilëve nga 2 ekzemplarë i marrin palët kontraktuese, 1 ekzemplar Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

#### Neni 5 Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

#### PALËT

Komuna e Gjakovës



*Ardian Gjini*

Ardian Gjini

K.F. "GJAKOVA"

*Byci*

---

Sadik Byci